

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dhjetë ditët e Festivalit të Filmit dhe çmimet, drejtori Ilir BUTKA: Karakteri demokratik, madhështia e tij!
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/dhjetë-ditët-e-festivalit-te-filmit-dhe-cmimet-drejto-ri-ilir-butka-karak-i585928
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 06:57:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 12:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9bd5ed3f9c91303f55b7a9169e4a8bae99c77dfe5ae53d8ee440ba7864293e
TEKSTI	f8ac2be4d29868636b881803a7d4b88d90b81b60d6f0bedf7a90d4410faf885f
PAMJA	0a4629d23cd4683af3428b6d6e2988d3a1a93453695e597701f649586722d728

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b7bdf8d693e336ec7d115b3022ea1087aca4ee15da10022bc7cca422e90b85c2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b7bdf8d693e336ec7d115b3022ea1087aca4ee15da10022bc7cca422e90b85c2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie [Viti i ri shkollor/ Presidenti Begaj uron nxenesit: E ardhmja eshte ne duart tuaja](#) [Magjistratet na treguan se problemi i Shqiperise jane vete ata](#) [Rama e dinte](#) [Kreth 90 ban](#)
fundit

Dhjetë ditët e Festivalit të Filmit dhe çmimet, drejtori Ilir BUTKA: Karakteri demokratik, madhështia e tij!



14 Shtator 2026, 14:53 Kulturë TEMA



Filmi “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja”, i Gentjan Koçit u shpall fitues i edicionit në një garë ku morën pjesë dhjetëra produksione shqiptare dhe bashkëprodhime

Tirana u kthye në qendrën e kinematografisë shqiptare (3-12 shtator) me rreth 220 filma të prodhuar nga viti 2012 e deri më sot, të cilët u shfaqën në katër hapësira: Universitetin e Arteve, Kinemanë “Agimi”, Piramidën e Tiranës dhe “Film Zone” në sheshin “Nënë Tereza”. Pavarësisht mendimeve dhe kritikave, drejtori Ilir Butka, ashtu si shumë artistë e konsideruan sukses jo thjesht rikthimin e festivalit të filmit, por më tepër se kaq, interesin që zgjoi te publiku i gjerë.

Pas 14 vitesh mungesë, Festivali i Filmit Shqiptar mbylli edicionin e tij të 14-të, duke sjellë në kryeqytet për dhjetë ditë radhazi emrat më të spikatur të kinematografisë shqiptare si dhe një numër të madh produksionesh kinematografike.

Ndarja e çmimeve, Tinka Kurti mes aktorëve të vlerësuar nga festivali

Mbrëmja gala, në të cilën merrnin pjesë protagonistë, artistë dhe artdashës të shumtë, shënoi kulmin e këtij edicioni, me ndarjen e çmimeve.

- Çmimi kryesor i festivalit, Kupa e Festivalit të Filmit, iu dha filmit “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja”, i realizuara nga Gentjan Koçi.
- Çmimi për Aktoren më të Mirë iu dha Adriana Matoshit, për interpretimin e saj në filmin “Luna Park”.
- Çmimi për Aktorin më të Mirë shkoi për Blerim Destanin, për rolin e tij në filmin “Amsterdam Express”.
- Çmimi për producentët më të mirë iu dha Dritan Huqit dhe Vlojca Dedej, duke vlerësuar kontributin e tyre në realizimin dhe promovimin e produksioneve kinematografike.
- Çmimi për regjisorin më të mirë shkoi për Gjergj Xhuvanin, një prej emrave më të njohur të kinematografisë shqiptare.
- Çmimi i Karrierës iu dha ikonës së kinematografisë dhe teatrit shqiptar, Tinka Kurti, në nderim të kontributit të saj të jashtëzakonshëm ndër vite.

Drejtori Butka: “Karakter i demokratik”, madhështia e filmit

Në një vend demokratik, të gjithë kanë të drejtën e fjalës, kritikës, mospajtit, apo të kontestimit. Organizatorët e filmit i thanë “*MAPO.al*” se duke respektuar çdo mendim, misioni i tyre është i qartë; të bëjnë atë çka është më e mundshme dhe e duhura për filmin.

Gjatë dhjetë ditëve të festivalit, sipas organizatorëve, rreth 20 mijë shikues ndoqën filmat dhe aktivitetet e festivalit në hapësirat e ndryshme të Tiranës.

Ilir Butka, drejtori i festivalit të filmit për MAPO përmendi si sukses jo vetëm rikthimin e festivalit por edhe pritjen e veçantë nga punliku.

“Kryeqyteti është mbështjellë nga magjia e artit të shtatë, duke u kthyer në epiqendrën e festës më të madhe të kinematografisë vendase përmes Festivalit Kombëtar të Filmit Shqiptar. Kjo ngjarje madhore solli një mozaik mahnitës me mbi njëqind produksione që dëshmuan gjallërinë e krijimtarisë sonë kinematografike. Në këtë edicion, ekrani i madh ndriçoi me tridhjetë e nëntë filma të gjatë artistikë, ku përfshihen dymbëdhjetë vepra të autorëve me karrierë të konsoliduar, katërbëdhjetë mendi debutuese që shënuan hapin e parë të një brezi të ri kineastësh, si dhe trembëdhjetë filma që u shfaqën jashtë konkurrimit zyrtar. Tridhjetë filma të shkurtër, tetë dokumentarë të thelluar, njëmbëdhjetë filma të animuar me fantazi të gjallë, si dhe pesëmbëdhjetë projekte të programit special, të cilat, meqenëse nuk financohen nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, mbetën jashtë garës për çmimet” theksoi drejtori Ilir Butka.

“Për të përthithur ritmin e ngjeshur artistik,” - sqaroi Butka, - “festivali u shtri në katër nga hapësirat më ikonike kulturore të Tiranës: Salla e Madhe dhe salla Black Box në Akademinë e Arteve, si dhe kinematë historike Agimi e Piramida. Çdo ditë, këto salla u shndërruan në strehë emocionale përmes pesë sloteve kohore të njëpasnjëshme.”

Juria e filmit të gjatë ishte e përbërë nga Bogdan Muresanu, Blerta Zeqiri, Haig Zaharian, Raimonda Bulku dhe Ylljet Aliçka; filmi i shkurtër mirëpriti vlerësimet nga Erenik Beqiri, Harvey Ascott dhe Virxhil Muçi; dokumentari u shqyrtua nga Esat Teliti, Fabrizio Bellomo dhe Përparim Kabo; ndërsa filmi i animuar i është besuar Agron Mesit, Rikarda Novës dhe Ilir Kasos. Së bashku, ata ndanë njëmbëdhjetë çmimet kryesore artistike. Paralelisht, një shtyllë e dytë vlerësimi ngrihet nga vetë komuniteti përmes Akademisë së Filmit, me mbi dyzet kineastë që votojnë online për pesëmbëdhjetë çmime teknike e profesionale. Shtylla e tretë i përket vetë artdashësve, të cilët përmes fletëve tradicionale apo skanimit të kodeve QR në dalje të sallave, përzgjedhin pesë çmimet e tyre të preferuara.

Ajo që e bëri këtë edicion vërtet madhështor, siç tha drejtori Butka, ishte karakteri i tij demokratik dhe përfshirës. Përmes një programimi të kuruar me kujdes, festivali shpërfaqti një programacion të gjërë ku çdo grupmoshë gjeti interesin specifik. “Festivali Kombëtar i Filmit në një udhëtim emocional ku askush nuk mbetet thjesht vëzhgues, por bëhet pjesë e pandashme e historisë së këtij eventi të jashtëzakonshëm kinematografik” u shpreh Butka. /mapo/

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Rreth 90 banesa monument kulture në Gjirokastrë pritet të shpëtohen nga ndërhyrjet e shtetit

08:43 Kulturë

Arti përtej kohës

Sot 82-vjetori i Çlirimit të Beratit/ Homazhe në Varrezat e Dëshmorëve



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.